



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА
ENTI SHETËROR I REVIZIONIT
STATE AUDIT OFFICE

Abstrakti i raportit përfundimtar i revizionit

Subjektet kyçe të përfshira me raportin e revizionit: Institucioni Shëndetësor Publik Qendra Klinike Universitare e Stomatologjisë Shën Pantelemon – Shkup

Lënda e revizionit:

Revizioni i raporteve financiare bashkë me revizionin e pajtueshmërisë të llogarisë për të hyrat personale - 531

Qëllimi i revizionit: Nëse raporti financiar është i liruar nga paraqitjet e gabuara materialisht dhe nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet në to janë në pajtim me rregullativën ligjore relevante.

Gjendjet kyçe të konstatuara:

- 17 persona janë punësuar me kontratë pune për vendet e punës të parashikuara me aktin për sistematizimin e vendeve të punës, ndërsa dhe nga ana tjetër gjatë vitit 2020 klinika ka marrë pëlqimin për punësim të rregullt të 17 personave, gjatë të cilës 8 nga vendet e planifikuara janë identike me vendet e punës për të cilat personat punësohen me kontratë pune dhe
- në pjesë nga procedurat e zbatuara për prokurime publike kemi konstatuar zbatim joadekuat të Ligjit për prokurim publik.

Mendimi i dhënë/përfundimi**:



Mendim me rezervë në lidhje me vërtetësinë dhe objektivitetin e raporteve financiare dhe mendim të pavolitshëm për pajtueshmërinë e transaksioneve financiare me rregullativën ligjore relevante për vitin 2020.

Rekomandimet kyçe:

- angazhimi i personave me kontratë pune të kryhet në përputhje me nevojat reale të Klinikës duke marrë parasysh numrin e punonjësve me kohë të plotë dhe sasinë e shërbimeve shëndetësore të kryera.
- ndërmarrjen e aktiviteteve për respektimin konsekuent të dispozitave të Ligjit për prokurim publik

Theksimi i pyetjes për pasiguri dhe vazhdimësi:

Klinika ka kërkesa të papaguara nga

- Ministria e Shëndetësisë për shërbime të kryera shëndetësore sipas programeve për mbrojtje shëndetësore në vlerë prej 7.006 mijë denarë, ndërsa nga ana tjetër ka marrë obligime nga Ministria në shumë prej 13.177 mijë të cilat nuk janë shlyer deri në ditën e kryerjes së revizionit;
- Fakulteti Stomatologjik për shpenzime materiale për ushtrime studentore që datojnë nga viti 2014 në vlerë prej 2.361 mijë denarë.

Vërejtjet e marra të draft-raportit: Nuk janë marrë vërejtje mbi draft-raportin e revizorit të autorizuar shtetëror numër 25-720/2 nga 16.03.2022.

* pozitive, me rezervë, të pavolitshëm, të përmbajtur